

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8198
E premte, 5 dhjetor 2025
Çmimi 0.50 €

Mogherini jep dorëheqje
nga pozita e rektores pas
akuzës për mashtrim
dhe korrupsion

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KQZ-ja, GATI PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka marrë disa vendime rreth përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. KQZ-ja ka certifikuar 23 subjekte politike për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Ndërkaq, rekomandimi për certifikimin e partisë politike Lista Srpska nuk ka marrë votat e nevojshme për t'u certifikuar. KQZ-ja ka marrë vendim edhe për emërimin e 215 anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në 38 komunat e Kosovës të cilët përfaqësojnë subjekte të ndryshme politike

**ÇFARË PO
NDODH NË
SHTËPINË E
PROKURORËVE
TË KOSOVËS?**

F. 4



**SAMI LUSHTAKU
BETOHET NË SKENDERAJ:
TË MOS HARROJMË
LIDERËT TANË QË
MBAHEN PADREJTËSISHT
NË HAGË**

F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



**FFK-ja: KOSOVA RENDITET E 41-A NË
LISTËN E 'FAIR-PLAY'-T TË UEFA-S**

F. 11



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

MOGHERINI JEP DORËHEQJE NGA POZITA E REKTORES PAS AKUZËS PËR MASHTRIM DHE KORRUPSION

BRUKSEL, 4 DHJETOR - Ish-shefja për Politikë të Jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka dhënë dorëheqje si udhëheqëse e Kolegjit të Evropës pasi iu ngrit aktakuzë për mashtrim dhe korrupsion. “Në përputhje me rigorozitetin dhe drejtësinë maksimale me të cilat kam kryer gjithmonë detyrat e mia, sot vendosa të jap dorëheqje”, tha Mogherini përmes një deklarate. Mogherini, që ishte përfaqësuese e lartë për Punë të Jashtme nga viti 2014 deri më 2019 para se të bëhej rektore e kolegjit, u arrestua të martën pas bastisjeve në këtë kolegji dhe në zyrat e shërbimit diplomatik të BE-së. Mogherini e ka ndërmjetësuar për disa vjet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë.

Italia 52-vjeçare u ndalua së bashku me zëvendësrektorin e shkollës dhe Stefano Sanninon, zyrtar i lartë i BE-së që ishte sekretar i përgjithshëm në Shërbimin për Veprim të Jashtëm Evropian nga viti 2021 deri më 2024. Pasi u mor në pyetje nga policia belge, “tre individët zyrtarisht u njoftuan për akuzat kundër tyre”, tha Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) të enjten, që mbikëqyr hetimin. “Akuzat lidhen me mashtrim në prokurim dhe korrupsion, konflikt interesi dhe shkelje të sekretit profesional”, shtoi EPPO-ja në njoftim. EPPO-ja po heton dyshimet për mashtrim që lidhen me një program trajnimit për diplomatët e rinj, të financuar nga BE-ja, i

njohur si Akademia Diplomatike e BE-së. Programi iu dha Kolegjit të Evropës nga Shërbimi i Jashtëm i BE-së në periudhën 2021-2022 dhe hetimi përqendrohet në atë nëse procesi tenderues është devijuar për ta favorizuar këtë shkollë. Mogherini e kishte udhëhequr Kolegjin e Evropës nga viti 2020 dhe më 2022, po ashtu, mori drejtimin e Akademisë Diplomatike të BE-së. Kontrata në fjalë kishte vlerën e 650 mijë eurove, raporton AFP, duke cituar një burim evropian. Të mërkurën, Sannino, i dyshuar në këtë rast, po ashtu njoftoi për dorëheqje nga pozita e tij aktuale në Komisionin Evropian, duke theksuar se do të dalë në pension në fund të muajit.



GJERMANIA SYNON NDËSHKIMIN E PERSONAVE QË GËNJENJË GJATË PROCESIT TË NATYRALIZIMIT



BERLIN, 4 DHJETOR - Kushdo që ofron informacion të tremë apo të paplotë gjatë procesit të natyralizimit do t'i ndalohet që të bëhet shtetas gjerman për dhjetë vjet. Kështu thuhet në një amendament të një projektligji që përcakton vendet e sigurta të origjinës përmes një dekreti, që u miratua më 3 dhjetor nga Komisioni për Punë të Brendshme i Budestagut. Anëtarët e Komisionit nga grupi parlamentar konservator të Socialdemokratëve dhe të partisë të ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë, votuan në favor të versionit të modifikuar të projektligjit.

Të Gjelbrit dhe të Majtët votuan kundër. Ndryshimi vjen si përgjigje ndaj hetimeve lidhur me shitjen e certifikatave të falsifikuara të gjuhës në disa lande gjermane. Projektligji, që do të diskutohet dhe votohet përfundimisht në seancën plenare të së premtes, tani përcakton se ndalimi duhet të zbatohet për një periudhë prej dhjetë vjetësh nëse shtetësia është revokuar në mënyrë të pakthyeshme ose nëse një aplikues ka “mashtruar me qëllim, ka kërcënuar apo ka dhënë rryshfet”. Ndalea, po ashtu, duhet të zbatohet ndaj një të huaji që

qëllimshëm ka dhënë informacione të pasakta ose të paplota mbi kushtet kryesore për marrjen e shtetësisë përmes natyralizimit. Projektligji i amendamentuar shton se ndalesa “shërben për të vënë në pah ligjin në fuqi dhe për ta shmangur nxitjen e shkeljes së ligjit”. Një ndryshim tjetër që është propozuar parasheh heqjen e së drejtës për mbështetje juridike të financuar nga shteti për personat që mbahen në qendra ndalimi për dëbim ose në paraburgim teksa presin që të largohen nga vendi - një e drejtë që ka nisur së zbatuari vitin e kaluar.

IZRAELI THOTË SE DO TA HAPË PIKËKALIMIN E RAFAHUT “NË DITËT NË VIJIM”

JERUSALEM, 4 DHJETOR - Izraeli njoftoi për një hapje të pjesshme të pikëkalimit kufitar të Rafahut, që lidh Rripin e Gazës me Egjiptin si pjesë e marrëveshjes së armëpushimit me Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëkalimi do të hapet vetëm për palestinezët që duan të largohen nga territori. “Në përputhje me marrëveshjen e armëpushimit dhe nën udhëzimin e spektrit politik, pikëkalimi i Rafahut do të hapet në ditët në vijim ekskluzivisht për daljen e banorëve nga Rripi i Gazës për në Egjipt”, tha COGAT, që është autoritetet përgjegjës për zbatimin e politikave izraelite

në territoret palestineze. “Dalja e banorëve përmes pikëkalimit të Rafahut do të lehtësohet përmes koordinimit me Egjiptin, pas miratimeve të sigurisë të bëra nga Izraeli dhe nën mbikëqyrjen e misionit të Bashkimit Evropian”, u tha në njoftim. Në një njoftim të Shërbimit për informim shtetëror të Egjiptit u mohua koordinimi me Izraelin për hapjen e kufirit në Rafah në ditët në vijim. Duke cituar një burim zyrtar egjiptian, agjencia deklaroi se, në rast të një marrëveshjeje për ta hapur pikëkalimin, qarkullimi kufitar do të zhvillohej në të dy drejtimet - si për hyrje, po ashtu edhe për dalje nga Rripi i Gazës. Kjo do të



ishite në përputhje me qasjen e formuluar në propozimin e presidentit amerikan Donald Trump për armëpushim, u tha në deklaratë.

COGAT tha se procesi pas rihapjes së kufirit do të ishte i ngjashëm me mekanizmin që ekzistonte në janar 2025, kur pikëkalimi u hap për një

periudhë të shkurtër për ta lejuar daljen e banorëve të plagosur të Gazës dhe më pas u mbyll sërish. Hapja e kufirit me Egjiptin është shtyrë disa herë që nga arritja e marrëveshjes për armëpushim më 10 tetor. Që atëherë palestinezët kanë mundur të largohen nga Rripi i Gazës vetëm përmes pikëkalimit Kerem Shalom, me kufizime të rrepta. Izraeli nuk dëshiron që Rafahu të shërbejë si pikëkalim për t'i lejuar dërgesat e ndihmave humanitare, të cilat kryesisht mbërrijnë në Gaza përmes pikëkalimit Kerem Shalom. BE-ja planifikon të kontribuojë në operacionet e monitorimit në Rafah përmes misionit të saj civil për Asistencë Kufitare sapo pikëkalimi të hapet.

Agim Çeku shkon në AAK, i hyn garës për deputet

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka njoftuar të enjten për aderimin e gjeneral Agim Çekut në listën e AAK-së për deputet, duke e cilësuar atë një nga figurat më të rëndësishme të luftës dhe të

paqes në vend. Haradinaj ka vlerësuar lart angazhimin e Çekut, i cili iu përgjigj thirrjes së atdheut si oficer i respektuar lufte në Kroaci, duke u vënë në krye të operacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që në ditët e para.

Ai ka kujtuar se Serbia e Millosheviqit u largua me turp nga Kosova, duke lënë pas krime dhe plagë që ende sot i ndien Qyshku - vendi i masakrave famëkeqe - po ashtu siç i bart me vete edhe familja e gjeneralit Çeku. “Gjeneral Çeku ka qenë

vazhdimisht partner i respektuar i aleatëve tanë të sigurisë. Do ta vazhdojmë bashkë shërbimin ndaj atdheut edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, krah teje dhe krah secilit në këtë vend”, ka deklaruar Haradinaj.



KQZ-ja, GATI PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka marrë disa vendime rreth përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. KQZ-ja ka certifikuar 23 subjekte politike për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Ndërkaq, rekomandimi për certifikimin e partisë politike Srpska Lista nuk ka marrë votat e nevojshme për t’u certifikuar. KQZ-ja ka marrë vendim edhe për emërimin e 215 anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në 38 komunat e Kosovës të cilët përfaqësojnë subjekte të ndryshme politike



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar të enjten rreth përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. Në këtë mbledhje, KQZ-ja mori disa vendime në kuadër të këtij procesi zgjedhor. KQZ-ja mori këto vendime: Vendimin për miratimin e procedurës së votimit dhe numërimit në vendvotim; Vendimin për miratimin e kurrikulës së trajnimit “Trajnimi i trajnerëve”; Vendimin për miratimin e programit të trajnimit për trupat menaxhuese të zgjedhjeve dhe stafin zgjedhor; dhe vendimin për miratimin e planit të sigurisë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Një ditë më parë, KQZ-ja mori vendim edhe për certifikimin e subjektit politik të 23 me radhë për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Sipas vendimit të KQZ-së, certifikohet subjekti politik Nisma Socialdemokrate, e cila

brenda afatit ka dorëzuar listën e përmirësuar me nënshkrimet e mbështetësve. Gjatë periudhës 7-ditore (24 nëntor - 30 nëntor 2025) 24 subjekte politike, prej të cilave 18 parti politike, 3 koalicione, 2 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur, kanë plotësuar online formularin e certifikimit për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Në mbledhjen e 87-të, më 2 dhjetor 2025, KQZ mori vendim për certifikimin e 22 subjekteve politike (16 parti politike, 3 koalicione, 2 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur) për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Ndërkaq, rekomandimi për certifikimin e partisë politike Srpska Lista nuk ka marrë votat e nevojshme për t’u certifikuar. Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë për të mos e certifikuar Listën Serbe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka theksuar se përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për ta bllokuar certifikimin e Listës

Serbe “janë shkurtpamëse dhe përçarëse”. Në pikën tjetër të rendit të ditës, KQZ-ja mori vendim për miratimin e rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së për zhvillimin e procedurave emergjente ekstreme për aktivitetet e prokurimit që lidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Këto përfshijnë një sërë aktivitetesh të domosdoshme për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme si: shtypja e fletëvotimeve, broshurave dhe listave përfundimtare të votuesve; furnizim me material për votim jashtë Kosovës; shërbimet postare për organizimin e votimit ashtë Kosovës (dërgimi i pakove me fletëvotime, dërgimi i materialeve zgjedhore dhe kthimi i materialeve dhe dërgesave postare); pakot e trajnimit për zgjedhjet e parakohshme; doracakët e trajnimit; plani për informim dhe edukim të votuesve;

transporti për materialin zgjedhor; format zgjedhore; kabinat e votimit; ngjyrat matrikulare; furnizim me vula; materialet administrative për pakot me fletëvotime; distinktiv për KKZ, trajnerët, KVV-të, stafin teknik, QNR, SKQZ dhe vëzhguesit e zgjedhjeve; lidhëset e sigurisë për kutitë e votimit; shërbimi i mirëmbajtjes dhe përkrahjes teknike, eksportimi - ruajtja dhe fshirja e regjistrimeve të vendvotimeve: instalimi, konfigurimi, testimi i kamerave në QKN si dhe furnizimi i pajisjeve të rrjetit në QKN; transporti për stafin QNR / Depo; furnizim me sistemin e kamerave dhe kontrollin e qasjeve në QNR; dhe furnizim me materiale për votim jashtë Kosovës. Në kuadër të vazhdimit të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, KQZ mori vendim për miratimin e specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve,

broshurave të kandidatëve dhe listave të votuesve. Dokumenti i miratuar është për qëllim të tenderimit të shtypjes së fletëvotimeve, broshurave ë kandidatëve si dhe listave të votuesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Dizajni dhe numri i saktë i fletëvotimeve që do të shtypen, do të vendoset nga KQZ në një fazë të mëvonshme, pas certifikimit të subjekteve politike, kandidatëve dhe listës së votuesve. Në vazhdim të mbledhjes, KQZ mori vendim për emërimin e 215 anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në 38 komunat e Republikës së Kosovës, të cilët përfaqësojnë subjektet e ndryshme politike. Sipas Ligjit nr. 08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme, KKZ administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor.

Protesta e radhës për çlirimtarët, më 13 dhjetor në Shkup

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Protesta e radhës në mbështetje të çlirimtarëve të Kosovës që po mbahen në

paraburgim në Hagë raportohet se do të mbahet më 13 dhjetor në Shkup. Lajmin e ka dhënë Ali

Ahmeti, kryetar i BDI-së. Raportohet se protesta do të mbahet me fillim nga ora 13:00.

Deri më tani protesta të këtij lloji janë mbajtur në Prishtinë, Hagë, Tiranë dhe Strasburg.





ÇFARË PO NDODH NË SHTËPINË E PROKURORËVE TË KOSOVËS?

Janë bërë më shumë se dy javë që kur ka shpërthyer sherri në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Sa flitet për shkarkim të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, më pas lindin dyshimet rreth tentimeve për bllokim të reformës së domosdoshme në këtë institucion. Ku është problemi?

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Puna brenda Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) rëndom nuk merr vëmendje të madhe. KPK-ja organizon sistemin prokurorial në Kosovë dhe, mes të tjerash, emëron kandidatët për prokurorë dhe bën vlerësimin e performancës së tyre.

Pra, janë kryesisht çështje procedurale, ose shumë teknike, kjo derisa nuk thirren konferenca të jashtëzakonshme gati çdo ditë dhe shkëmbehen akuza e kundëra mes figurave të rëndësishme aty. Ose, derisa të mos ketë reagime të faktorit ndërkombëtar dhe ngritje alarmi nga organizatat që e monitorojnë punën e sistemit të drejtësisë.

Të gjitha këto ndodhën ditët e fundit brenda shtëpisë së prokurorëve të Kosovës, dhe problemet duket se vetëm po thellohen.

E nisim nga e para.

Më 20 nëntor anëtarë të KPK-së e shkarkuan Besim Kelmendin nga pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të

Shtetit. Shkarkimi i Kelmendit ndodhi një ditë pasi ai u paraqit në Prokurorinë Speciale të Kosovës, si dëshmitar lidhur me punën e tij në gjykatë në kohën kur kishte ndodhur masakra e Reçakut më 1999. Kelmendi tha se vendimi ishte i paligjshëm dhe e çoi rastin për shqyrtim në gjyq. Në anën tjetër, kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, pretendoi publikisht se vendimi ishte marrë në përputhje me ligjin. Për njohësit e drejtësisë ky arsyetim nuk qëndron, pasi ai ishte ftuar si dëshmitar, e jo si i akuzuar në gjykatë dhe, për me tepër, duket se nuk është ndjekur asnjë procedurë e nevojshme për shkarkimin e tij. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe disa organizata të tjera që e monitorojnë sistemin e drejtësisë thanë se vendimi ndaj Kelmendit ishte “i paligjshëm, arbitrar dhe abuziv”, ndërsa u përmend “përbërja korporatiste” dhe një “grup i stërvjetër i interesit” brenda KPK-së.

Edhe në disa vlerësime të

Komisionit të Venecias janë përmendur disa herë tendencat korporatiste brenda KPK-së si dhe urgjenca për ndryshime në këtë institucion. Për këtë arsye u tha se reformat janë thelbësore.

Ish-ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, pretendoi se KPK-ja “prej kohësh është e kapur nga grupe interesi”. “Reforma në KPK pritet të jetësohet në janar 2026. Ky është një hap i domosdoshëm për rikthimin e integritetit në institucion”, tha ajo.

Zbatimin e plotë të reformës e kërkoi edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë pas një takimi që zhvilloi me anëtarë të KPK-së më 3 dhjetor.

Për çfarë reformash bëhet fjalë?

Duke i pasur parasysh vlerësimet e Komisionit të Venecias, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe nevojën për pluralizëm, ndryshimet në Ligjin për KPK-në, që hynë në fuqi në qershor të këtij viti, parashohin që institucioni t’i ketë 7 anëtarë, për dallim nga 13 sa i ka tani, dhe të ketë edhe anëtarë joprokurorë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës. Reforma pritet të fuqizohet plotësisht në janar, kur u skadon mandati pesë anëtarëve aktualë, të cilët nuk mund të rizgjidhen. Me

ndryshimet e reja, kuorumi për ta mundësuar vendimmarrjen arrihet në formatin pesë plus një anëtar.

Kelmendi u shkarkua me pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje - katër prej të cilëve u skadon mandati në janar. Situata aktuale brenda KPK-së përshkruhet si “luftë brenda llojit” nga Vullnet Bugaoku, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI). “Luftë brenda grupeve, dy grupeve të përbërjes aktuale. Është ai grupi i kastës së vjetër të KPK-së, të cilët po tentojnë të kenë ndikim dhe fuqi në vendimmarrjen e KPK-së, dhe është përbërja tjetër, të cilët po tentojnë që zëshëm ta realizojnë në tërësi reformën në KPK, sipas dispozitave të ligjit të ri dhe vlerësimeve të Komisionit të Venecias”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Një anëtar i KPK-së e akuzoi Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, se qëndron mbrapa tentimeve për ta shkarkuar Kelmendin, por Prokuroria mohoi çdo ndërhyrje.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, nuk e dekretoi Isufajn për Kryeprokuror të Shtetit në tetorin e 2023-s, duke përmendur shkelje në procesin e përzgjedhjes nga KPK-ja. Faktori ndërkombëtar kritikoi mënyrën e përzgjedhjes së Isufajt nga KPK-ja dhe disa herë ka kërkuar që procesi të kthehet në pikën zero.

Problemi i radhës...

Për t’i hedhur edhe më shumë benzinë zjarrit, KPK-ja nuk e miratoi më 1 dhjetor raportin për zgjedhjen e anëtarit të saj të ri. Kryesuesi Hajdaraj tha se procesi pati defekte serioze dhe pretendoi se ishin premtuar favore.

Për shoqërinë civile, këto veprime po merren kundërligjshëm nga një pjesë e anëtarëve të KPK-së, shumicës prej të cilëve u kalon mandati në fillimin e vitit.

OJQ-të vlerësojnë se përzgjedhja e anëtarit të ri - Elza Bajrami-Kastrati fitoi më së shumti vota për një mandat pesëvjeçar në KPK - u bë duke u bazuar në një proces krejtësisht transparent. Sikur për rastin e Kelmendit, ashtu edhe për plotësimin e pozitës së anëtarit të ri në KPK, vendimin përfundimtar duket se do ta marrin gjykatat.

Por, një gjë është e sigurt: gjithë këto zhvillime do ta dëmtojnë vendin në sytë e ndërkombëtarëve. “Kosova mund ta ketë edhe kushtëzim [nga BE-ja], mund ta ketë si kriter matës të asaj se sa ka gatishmëri institucionale që reformat që janë realizuar në letër të realizohen edhe në praktikë”, vlerëson Bugaoku.

Edhe në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën për këtë vit u përmend që udhëheqja e KPK-së ka treguar vendosmëri të kufizuar për avancimin e sundimit të ligjit.

ASK-ja PUBLIKON INDEKsin E ÇMIMEVE TË PRONAVE BANESORE: ÇMIMET NË RRRITJE, PRISHTINA KRYESON 6.5 %

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë Indeks të Pronave Banesore (IÇPB), një raport që mat lëvizjet e çmimeve të banesave në vend dhe që synon të ofrojë transparencë dhe standarde të unifikuara statistikore për tregun e pasurive të paluajtshme. Sipas të dhënave të paraqitura, çmimet e pronave banesore në tremujorin e dytë të vitit 2025 janë rritur për 4.2 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa në rajonin e Prishtinës rritja arrin në 6.5 %.

Drejtori ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha se për herë të parë në Kosovë publikohet një indeks i standardizuar për çmimet e pronave banesore. Ai thekson rëndësinë që ky indeks i jep vendit jo vetëm si statistikë vendore, por edhe si instrument për instrumente ndërkombëtare. “Sot për herë të parë ASK-ja e publikon një raport të rëndësishëm jo vetëm për vendin por edhe për institucionet ndërkombëtare. Për herë të parë matet indeksi i pronave banesore në Kosovë. Ky indeks është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertizën e Bankës Qendrore dhe është në harmoni me protokollin e Fondit Monetar. Është indeksi

i tetë më radhë që kemi prodhuar. Ky është raporti i parë dhe do ta plotësojmë në ndërkohë”, tha ai. Përfaqësuesi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Kujtim Mustafa, ka sqaruar se procesi për krijimin e këtij indeksi nuk ka qenë i lehtë. “Sfidat më të mëdha vijnë nga mungesa e harmonizimit ligjor dhe hezitimi për shkëmbimin e të dhënave ndërinstytucionale. Meqenëse kemi kaluar sfidën e digjitalizimit të këtyre, sfidë është procesi ligjor. Shumë institucione akoma hezitojnë shkëmbimin e këtyre informatave për shkak se thonë se, bazuar në ligjin që kemi në institucionin tonë, nuk mund t’i shpërndajmë informatat. Fatmirësisht ASK-ja dhe AKK-ja kanë pasur një bashkëpunim të shkëlqyer dhe kanë shpërndarë të dhënat që kanë dhe i grumbullojnë prej të gjitha komunave në Kosovë”, tha ai. Ilir Berisha, drejtor i statistikave në ASK, tha se indeksi ishte kërkesë e qeverisë dhe pjesë e marrëveshjes me FMN-në. “Ky indeks ka qenë kërkesë e qeverisë në vitin 2023 në bazë të një marrëveshje me Fondin Monetar, e cila ka qenë pikë e veçantë në këtë marrëveshje. Një prej kushteve të plotësohet ka qenë edhe



publikimi i këtij indeksi”, tha ai. Gëzim Ahmeti, zyrtar i Statistikave të Çmimeve në ASK, paraqiti të dhënat kryesore të IÇPB-së, duke theksuar trendin rritës ndër vite. “Në nivel vendi çmimet e pronave banesore në tremujorin e dytë të vitit 2025, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2024 ka pasur rritje prej 4.2 për qind. Kurse

te rajoni i Prishtinës ka shënuar një rritje prej 6.5 për qind, ndërsa për rajonet e tjera të vendit ka pasur një ngritje prej 0.7 për qind. Në këtë grafik kemi paraqitur ndryshimet vjetore në përqindje, dhe janë ndryshimet mesatare duke filluar nga viti 2019, e cila është 2.1 për qind, në vitin 2020 - 0.2 për qind për shkak të pandemisë si dhe në vitin

2021 - 2.4 për qind, në vitin 2022 - 4.5 për qind, në vitin 2023 - 3.7 për qind si dhe në vitin 2024 - 4 për qind. Kjo paraqitje e indeksit të çmimeve të pronave të banimit fillon prej vitit 2018 deri në vitin 2024 dhe në bazë të këtij grafiti e shohim se ka një trend ngritës, nga viti 2018 deri në vitin 2024, e cila ka arritur një vlerë të indeksit në 118.1 për qind”, tha ai.

KQZ-ja PËRMBYLLË ZGJEDHJET LOKALE 2025, CERTIFIKON REZULTATET ZGJEDHORE TË FUNDIT TË KUVENDIT KOMUNAL TË ISTOGUT

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përmbyllur procesin e zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Në mbledhjen e mbajtur të enjten, KQZ-ja ka certifikuar rezultatet e fundit nga këto zgjedhje, që i takon Kuvendit Komunal të Istogut. Më herët, më 21 nëntor 2025, KQZ-ja kishte certifikuar rezultatet përfundimtare për 37 kuvendet komunale për këto komuna: Deçan, Gjakovë, Glogoc, Gjilan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Podujevë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot dhe Mitrovicë e Veriut. Në këtë vendim të KQZ-së nuk përfshihej rezultati i zgjedhjeve për Kuvendin Komunal të Istogut, pasi ende nuk ishte



përmbyllur vendimmarrja lidhur me ankesën e një

kandidati për anëtar të këtij Kuvendi Komunal.

Ndërkaq, rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të

komunave janë certifikuar në dy mbledhje të ndryshme. Fillimisht, më 3 nëntor, KQZ-ja ka certifikuar rezultatet e raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të 35 komunave, ndërkaq më 8 nëntor rezultatet e 3 komunave të tjera. Nga numri i përgjithshëm i komunave, në 20 prej tyre fituesit janë zgjedhur në raundin e parë, si: Deçan, Glogoc, Kamenicë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Ferizaj, Zubin Potok, Zveçan, Malishevë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Mitrovicë e Veriut. E rezultatet e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave janë certifikuar më 27 nëntor për këto 18 komuna: Gjakovë, Gjilan, Dragash, Kaçanik, Klina, Fushë-Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Viti, Vushtrri, Junik, Mamushë dhe Klokot.

Britaniku Jon Harrison, veteran i luftës në Kosovë, merr nënshtetësinë e Kosovës

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Britaniku, Jonathan Mark Harrison, i njohur si Jon Harrison veteran i luftës në Kosovë ka marrë

nënshtetësinë e Republikës së Kosovës. Këtë e bëri me dije vet Harrison përmes një postimi në rrjetin social në

“Facebook”. “Zonja dhe zotërinj, jam shpallur shtetas i Republikës së Kosovës”, ka shkruar ai. Edhe nga zyra e

presidencës për Telegrafin konfirmuar dhënien e nënshtetësisë me dekret të presidentes, Vjosa Osmani.



AUDITORJA E PËRGJITHSHME THEKSON RËNDËSINË E BESIMIT DHE PAVARËSISË INSTITUCIONALE

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Nga 1 deri më 4 dhjetor 2025 në Dubrovnik të Kroacisë u mbajt Seminari Vjetor i Auditorëve në të cilin morën pjesë auditorja e përgjithshme Vlora Spanca, zëvendësauditori i përgjithshëm Beza Halilaj dhe ndihmësauditori i përgjithshëm Agron Fetiu. Ky aktivitet u organizua nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë dhe bëri bashkë drejtues dhe zyrtarë të lartë të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vendet e rajonit dhe Bashkimi Evropian, përfshirë Sllovakinë, Maltën, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën si dhe përfaqësues shtetërorë të

Kroacisë.

Auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, mbajti një fjalë rasti në hapje të punimeve të Seminarit, ku vuri në dukje rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në forcimin e besimit të qytetarëve, domosdoshmërinë e ruajtjes së pavarësisë institucionale dhe sfidat me të cilat përballen. “Sot, më shumë se kurrë, qytetarët kërkojnë institucione që jo vetëm flasin për integritet, por e mishërojnë atë. Pavarësia nuk është vetëm kërkesë ligjore, por shpesh provë guximi”, tha Spanca.

Duke iu referuar rezultateve të Barometrit Ballkanik, si një tregues i qartë i pavarësisë dhe profesionalizmit të institucionit,



ajo tha se besimi i qytetarëve në punën e ZKA-së ka vazhduar të rritet. “Ne kemi punuar për ta forcuar zërin tonë,

profesionalizmin dhe lidhjen me publikun. Sfidat që hasim na motivojnë të zhvillohemi më tej, të mësojmë dhe t'i qëndrojmë

besnik misionit tonë”, tha Spanca. Ajo, po ashtu, nënvizoi nevojën për më shumë transparencë, komunikim më të qartë me publikun dhe forcim të sistemit të përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve në sektorin publik. Në mbyllje të fjalës së saj, Spanca theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe besimin se bashkërisht mund të ndërtohet një e ardhme më e mirë për qytetarët. Programi i seminarit përfshiu prezantime dhe diskutime mbi sfidat metodologjike të auditimit si dhe sesione për risitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.

NJË BURRË DËNOHET ME DY VJET BURGIM PËR SULM NDAJ USHTARËVE TË KFOR-it DHE POLICISË SË KOSOVËS NË ZVEÇAN

ZVEÇAN, 4 DHJETOR - Gjykata Themelore e Prishtinës e ka dënuar të enjten me burgim dhe gjobë një burrë, pasi ai e pranoi fajësinë për dhunën e ushtruar ndaj ushtarëve të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë si dhe pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dy vjet më parë. Lubisha Millkoviq u dënua me dy vjet burgim dhe 14 000 euro gjobë për sulm ndaj ushtarëve të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës në protestën e 29 majit 2023 në Komunën e Zveçanit. Millkoviq e pranoi fajësinë në një marrëveshje me Prokurorinë Speciale, e cila e akuzoi atë për



veprat penale sulm ndaj personit zyrtar dhe pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizmi. Avokati mbrojtës i Millkoviqit, Millosh Deleviq, tha se marrëveshja për pranimin e fajësisë është arritur me vullnet të

plotë, raporton “Betimi për Drejtësi”. Millkoviq u arrestua më herët këtë vit dhe gjykata tha se ai do të mbahet në paraburgim derisa aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë. Më shumë se 90 pjesëtarë të

KFOR-it kishin pësuar lëndime - disa prej tyre lëndime të rënda - pas përleshjes me protestuesit serbë majin e atij viti. Të lënduar nga kjo përplasje pati edhe në anën e protestuesve. Dhuna në Zveçan shpërtheu pasi serbët lokalë kundërshtuan hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më herët po atë vit, që u bojkotuan nga serbët. Autoritetet e Kosovës kanë arrestuar dhe akuzuar dhjetëra të dyshuar për dhunën në Zveçan

vitin e fundit. Deri tani disa persona janë dënuar me burgim pas marrëveshjeve me prokurorinë për pranimin e fajësisë në lidhje me dhunën në Zveçan. Për dhunën në Zveçan, Kosova e ka fajësuar Serbinë, duke thënë se pas dhunës qëndruan “grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq”. Por, Beogradi e ka hedhur poshtë këtë akuzë, duke thënë se Qeveria e Kosovës synonte t'i shtynte serbët “drejt një konflikti të ri me NATO-n”. NATO-ja vazhdimisht ka kërkuar që autorët e dhunës të mbahen përgjegjës.

BURIM RAMADANI, KANDIDAT PËR DEPUTET I AAK-së



PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Burim Ramadani është mendje e kthjelltë që punon për sigurinë e shtetit. Sipas tij, është ndër njerëzit më të

përgjegjshëm dhe profesionistët më të përgatitur që ai njeh. “Besnikëria ndaj shtetit, integriteti i tij, përvoja dhe aftësitë e bëjnë një vlerë të veçantë për Kosovën. E

mbështes plotësisht kandidimin e tij për deputet, sepse besoj që zëri dhe veprimi i tij racional, kritik dhe i matur do t'i shërbejë shtetit. Kosova ka nevojë për të. Ne kemi nevojë

për të. Jam i lumtur që pranoi kërkesën tonë që të kandidojë për deputet dhe shpresoj se do të jemi bashkë në Parlament”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Latifi: Bashkë në mbështetje të fushatës '16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore'

RAHOVEC, 4 DHJETOR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në tryezën e organizuar nga Qendra për Punë Sociale dhe OSBE-ja. Të pranishëm ishin përfaqësues institucionale, profesionistë të fushës sociale, të sigurisë, të arsimit dhe nga organizatat

partnere. Takimi kishte për qëllim diskutimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhe të miturve si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalim dhe reagim më efikas. “Në emër të Komunes

së Rahovecit, riafirmova gatishmërinë tonë për të mbështetur mekanizmat mbrojtës, për të forcuar kapacitetet lokale dhe për të qenë partner aktiv në çdo iniciativë që mbron fëmijët dhe të miturit”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



Abdixhiku vlerëson angazhimin e Britanisë për Kosovën

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur të enjten në selinë qendrore ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Në këtë takim, Abdixhiku dhe ambasadori Hargreaves diskutuan mbi zhvillimet e fundit politike në vend, si dhe qëndrimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës ndaj këtyre zhvillimeve, me theks të veçantë në procesin zgjedhor të

28 dhjetorit. Abdixhiku e informoi ambasadorin britanik për përgatitjet e LDK-së për zgjedhjet nacionale dhe angazhimin e partisë për një proces demokratik, të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Po ashtu, theksoi mobilizimin e strukturave në të gjitha komunat, finalizimin e programit qeverisës si dhe angazhimin e partisë për një fushatë konstruktive dhe të

orientuar kah qytetari. Abdixhiku nënvizoi se LDK-ja është e gatshme të paraqesë një ofertë serioze dhe vizionare për të ardhmen e vendit, duke u mbështetur në përvojën institucionale që ka. Abdixhiku i shprehu mirënjohjen ambasadorit Hargreaves për mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Kosovës në proceset e saj më të rëndësishme shtetformuese dhe demokratike.



SAMI LUSHTAKU BETOHET NË SKENDERAJ: TË MOS HARROJMË LIDERËT TANË QË MBAHEN PADREJTËSISHT NË HAGË

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

SKENDERAJ, 4 DHJETOR - Sami Lushtaku të enjten para anëtarëve të Kuvendit Komunal të Skenderajt është betuar në detyrën kryetar i kësaj komune. “Unë Sami Lushtaku, betohem që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Skenderajt, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”, ka thënë Lushtaku në betimin e tij para anëtarëve të Kuvendit Komunal të Skenderajt. “Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë e veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjeneralë të luftës, deputetë, anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqësues institucionalë, qytetarë të Skenderajt, të nderuar të pranishëm, sot qëndroj përsëri para jush me nderin më të madh që mund t'i jepet një biri



të kësaj toke - besimin tuaj për të udhëhequr Skenderajn, çerdhen e çdo lëvizje për çlirimin e Kosovës dhe vendin i cili u ngrit me gjak, mund e sakrificë. Para së gjithash, përulëm me respektin më të thellë para sakrificës së brezave që e bënë të mundur këtë ditë. Përulëm para emrit madhështor të Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari, familjes së tij heroike dhe çdo dëshmori që me gjakun e vet vulosi

themelet e lirisë”, ka thënë ai. Lushtaku ka thënë se sot nuk janë këtu vetëm për ta kujtuar të kaluarën, por për ta mbajtur gjallë amanetin e saj. “Ne kemi obligim të vazhdojmë aty ku ata e lanë, me punë, me përgjegjësi dhe me vendosmërinë e një populli që nuk dorëzohet kurrë. Të nderuar qytetarë, vendi ynë sot nuk përballlet me luftë frontale por përballlet me sfida të reja - sfida të zhvillimit, të ekonomisë, të arsimit, të

shërbimeve, të infrastrukturës dhe të barazisë e drejtësisë shoqërore. Këto sfida kërkojnë punë të palodhur, vullnet të hekurt dhe lidhë të guximshëm. Unë ju garantoj se do të jem kryetar i çdo qytetari - pa dallim bindjeje politike, familjare apo shoqërore. Në këtë ditë solemne, e kemi edhe një obligim moral: të mos harrojmë liderët tanë që sot mbahen padrejtësisht në Hagë, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin”, ka thënë ai, duke shtuar se ata që kontribuan aq shumë për lirinë që sot e gëzojmë meritojnë drejtësi nga ky proces. “Ne do të vazhdojmë t'i mbështesim me dinjitet, me zë të qartë dhe me besimin se e vërteta e luftës sonë çlirimtare do të triumfojë”, ka thënë Lushtaku. Ai ka thënë se zotohet se Skenderajn do ta bëjnë qytet të zhvillimit, të pastërtisë, të gjelbërimit, të sigurisë, rendit dhe mundësive për rininë tonë. “Zotohem se do të investojmë

në qytet e në fshatra, në arsim e në shëndetësi, në infrastrukturë e në shërbime publike, në kulturë e në mjedis. Bashkë do të investojmë në të ardhmen e qytetit tonë të përbashkët. Skenderaj do të ecë përpara dhe do të ecë me hapa të mëdhenj”, është shprehur ai. Në fund të fjalës së tij, Lushtaku ka thënë se as para zgjedhjeve nuk ka premtuar mrekulli, por premtion punë e angazhim të pareshtur e të pandalur. “Nuk premtoj fjalë të mëdha, por premtoj punë të mëdha. Dhe mbi të gjitha, premtoj se kurrë, asnjëherë, nuk do t'ju zhgënej në besimin që më dhatë. Bashkë do ta nderojmë të kaluarën e bashkë do të punojmë për ta ndërtuar të ardhmen”, ka deklaruar Lushtaku. Ai ka falënderuar kryetarin e deritanishëm, Fadil Nurën, për punën dhe angazhimin e madh gjatë mandatit, duke realizuar shumë punë dhe projekte konkrete pavarësisht prej vështirësive financiare me të cilat janë përballur.

UP-JA ME UNIVERSITETET IRLANDEZE BASHKËPUNOJNË NË PROGRAME TË PËRBASHKËTA



PRISHTINË, 4 DHJETOR - Në një takim në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës me ambasadorin jorezident të Irlandës në Kosovë, Ragnar Almqvist, u shqyrtuan mundësitë e forcimit të bashkëpunimit në mes të UP-së dhe universiteteve nga Irlanda.

Gjatë takimit u përmend dhe u përkrah nga drejtuesit e UP-së dhe ambasadori Almqvist edhe ideja e avancimit të programeve në fushat e studimeve të paqes dhe integriteteve evropiane duke marrë shembull të mirë ballafaqimin e shtetit të Irlandës me të kaluarën.

U fol edhe për zhvillimin e partneriteteve të UP-së me universitete irlandeze në fushën e arsimit të përbashkët e të integruar. Si mundësi e mirë u vlerësua edhe themelimi i një shkolle dimërore për studime të paqes në Universitetin e Prishtinës në të cilën do të

ligjëronin profesorë të UP-së dhe universiteteve nga Irlanda. Ambasadori Ragnar Almqvist u prit nga rektori prof. Arben Hajrullahu dhe prorektori për mësimdhënie dhe çështje të personelit akademik dhe botime, prof. Adem Beha. UP-ja ka tashmë një traditë bashkëpunimi

AGK-ja: Deklaratat e Sami Kurteshit, të papërgjegjshme dhe të rrezikshme

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka dënuar fuqishëm gjuhën e papërgjegjshme, sulmuese dhe shumë të rrezikshme të anëtarit të KQZ-së, Sami Kurteshi, nga partia politike Vetëvendosje. Kurteshi, në një reagim publik e quajti AGK-në “Aleancë të Grupeve Kriminale” dhe listoi një sërë mediesh që, sipas tij,

operojnë si “vrasës me pagesë”. “Këto akuza, përveç që janë të pabaza, paraqesin rrezik real për sulme të mundshme në të ardhmen ndaj gazetarëve dhe pjesëtarëve të mediave në punën e tyre profesionale në terren. Deklaratat nxitëse të urrejtjes të z. Kurteshi janë vazhdimësi e një fushate linçuese ndaj gazetarëve, me

qëllim frikësimit të tyre dhe minimin e lirisë së medias në vend”, thuhet në reagimin e AGK-së. AGK-ja e fton Vetëvendosjen, liderin e saj Albin Kurti dhe presidenten e Republikës, Vjosa Osmani, ta konsiderojnë largimin e Kurteshit nga pozicioni i tij në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



ÇFARË FSHIHET PAS BUMIT TË BIZNESEVE TË REJA QË TRUMBETON QEVERIA?

Edhe pse Qeveria në detyrë e Kosovës e konsideron hapjen e mbi 11 mijë bizneseve të reja si tregues i shëndetit ekonomik, ekspertët thonë se numri i lartë nuk mjafton, pasi shumica janë mikro-biznese me ndikim të kufizuar. Qarkullimi i sektorëve kyçë ekonomikë ka rënë, sidomos në prodhim dhe tregti, duke treguar se ekonomia nuk po gjeneron vlerë të shtuar. Modeli ekonomik i bazuar tek importi dhe tregtia e vogël është i paqëndrueshëm, dhe ekspertët kërkojnë politika që favorizojnë prodhimin, eksportin dhe rritjen e kapaciteteve të ndërmarrjeve



PRISHTINE, 4 DHJETOR - Mbi 11 mijë biznese të reja u regjistruan në Kosovë nga janari deri në tetor të këtij viti - një shifër kjo që nga qeveria në detyrë shihet si sinjal i gjallërisë ekonomike. Për ekspertët, megjithatë, numrat nuk tregojnë gjithë rrëfimin. Rritja e ekonomisë, sipas tyre, nuk matet me sa biznese hapen, por me sa prodhohet, sa shitet dhe sa eksportohet.

Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, e përshkroi këtë trend si "tregues të shëndetit të mirë të ekonomisë". Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, duke shpërndarë të njëjtin mesazh, tha se gjatë mandatit të tyre "numri i bizneseve të reja të regjistruara është ngritur vit pas viti", duke e paraqitur këtë si dëshmi të një ekonomie në zgjerim.

Por, njohësit e fushës së ekonomisë, Lulzim Rafuna dhe Shpend Ahmeti, shohin një tjetër realitet pas këtyre shifrave optimiste. Sipas tyre, struktura e bizneseve të reja nuk përbën dëshmi të rritjes së qëndrueshme ekonomike. Shumica e tyre janë mikro-biznese - shpesh me kapacitet të kufizuar punësimi dhe prodhimi.

Vetëm në tetor, nga 1 125 biznese të reja, 1 116 ishin mikro-ndërmarrje me deri në nëntë të punësuar, ndërsa

vetëm nëntë u klasifikuan si biznese të mesme - me 50 deri në 249 punëtorë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Asnjë ndërmarrje e madhe, me mbi 250 punëtorë, nuk u regjistrua në atë muaj. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se ky model është i njëjtë prej vitesh: hapen shumë biznese të vogla, por pak prej tyre rriten dhe diversifikojnë ekonominë. "Shumica janë start-up. Është pozitive që të rinjtë, viteve të fundit, po tregojnë interes gjithnjë e më të madh për të hapur biznese, por këto nuk mund të kenë ndikim të menjëhershëm në ekonominë e

përgjithshme", thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Shpend Ahmeti, bashkëthemelues i platformës Data4X, që mbledh dhe analizon të dhëna ekonomike, thotë se rritja ekonomike nuk matet me numrin e bizneseve të reja, por me qarkullimin real të bizneseve.

Të dhënat e Data4X tregojnë se nga janari në shtator të këtij viti, ka pasur rënie të qarkullimit pikërisht te sektorët e prodhimit dhe tregtisë - dy

motorët e vërtetë të ekonomisë.

I vetmi sektor me rritje qarkullimi ka qenë ai i furnizimit me energji elektrike. Ahmeti nënvizon domosdoshmërinë e fokusimit në prodhim, në mënyrë që Kosova ta zëvendësojë importin me eksport brenda pak viteve.

Me mbështetje të qëndrueshme institucionale, sipas tij, importi mund të zëvendësohet deri në një miliard euro nga eksporti. "Produktet me potencial të lartë për eksport, të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike, janë: përpunimi i pijeve, ushqimet e konservuara pa bazë shtazore, tekstili dhe materialet ndërtimore", thotë Ahmeti për Radion Evropa e Lirë.

Ekonomisti Shenoll Muharremi, njohës i politikave publike, shkon edhe më tej në kritikën e tij. Ai thotë se rritja e numrit të bizneseve nuk është domosdoshmërisht lajm i mirë, pasi shumica prej tyre janë biznese tregtare që varen nga importi. "Nuk ka asgjë të krenohet me këtë model, i cili duhet të ndryshohet. Me këtë import, ne nxjerrim jashtë

vendit gjashtë miliardë euro në vit nga tregtia në mallra", shkruan Muharremi në "Facebook".

Ai thotë se ky është indikator i qartë i dështimit të modelit ekonomik aktual.

Muharremi shton se një tjetër boshllëk domethënës është numri i vogël i bizneseve të reja në sektorin e bujqësisë, që, sipas ekspertëve, në vende të tjera zhvilluese është një prej bazave kryesore të ekonomisë së qëndrueshme.

Për ta kthyer ekonominë drejt prodhimit, Ahmeti sugjeron ndryshime konkrete në politika: pagesa e TVSh-së brenda vendit, e jo paraprakisht në doganë, për të liruar kapitalin e bizneseve; dhe lehtësira financiare, pasi shumë ndërmarrje përballen me mungesë të parasë së gatshme. Një model i tillë, thotë ai, do të rriste kapacitetet prodhuese, punësimin dhe rritjen e qëndrueshme.

Rritja ekonomike për gjysmën e parë të vitit 2025 ka qenë 3.8% - një shifër solide, por jo mjaftueshëm për të thyer rrethin e varësisë nga importi dhe atë të bizneseve mikro.

Ndërmarrjet e reja dhe ato të shuara gjatë një dekade

Mbi 11 mijë biznese janë regjistruar në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2025, sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), që vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Procesi i regjistrimit mbetet i thjeshtë dhe i shpejtë, me mundësi aplikimi në qendrat komunale të ARBK-së ose online.

Nga viti 2018 deri më 2025,

qarkullimi i bizneseve në Kosovë ka qenë vazhdimisht në rritje. Përfundimisht bëjnë vitin 2020, kur u shënuar një rënie për shkak të pandemisë COVID-19, dhe ky vit, kur regjistrohet një stagnim prej rreth 1 %.

Ndërkaq sektori i prodhimit ka shënuar rritje të qëndrueshme nga rreth 921 mijë euro në vitin 2018 në 1.9 miliard euro në vitin 2024. Megjithatë, në vitin 2025 ky sektor regjistron një rënie prej 9 %.

HAPET THIRRJA PËR ORGANIZATAT E PUNËTORËVE DHE ORGANIZATAT E PUNËDHËNËSVE PËR T'U PËRFAQËSUAR NË KËSHILLIN EKONOMIKO-SOCIAL

PRISHTINE, 4 DHJETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hapur thirrjen për organizatat e punëtorëve dhe organizatat e punëdhënësve të interesuara për t'u përfaqësuar në Këshillin Ekonomiko-Social.

Bazuar në ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES nga Organizatat e Punëtorëve janë: 1. Numri i përgjithshëm i anëtarëve, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i tërësishëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës (apo 41,449 të punësuar); 2. Numri i



Marrëveshjeve Kolektive të lidhura me ndërmarrjet apo institucionet e ndryshme; 3.

Numri i degëve sindikale të anëtarësuar në format e organizimit sindikal në nivel

nacional, të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES; 4. Numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve të tjera përmes Marrëveshjeve Kolektive dhe ndërmjetësimit; 5. Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare të Punëtorëve.

Ndërsa kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES për Organizatat e Punëdhënësve janë: 1. Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës (apo

19,699 ndërmarrje të regjistruara); 2. Numri i punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuar në Organizatat e Punëdhënësve të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES; 3. Numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve tjera, përmes Marrëveshjeve Kolektive dhe ndërmjetësimit; 4. Numri i ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera ekonomike të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në nxitjen e punësimit dhe zbutjen e papunësisë; 5. Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare të Punëdhënësve.

STRATEGJIA E RE E UKRAINËS KUNDËR MOSKËS: GODITENI FORT ENERGJINË RUSE. POR KIEVI PO PËRBALLET ME VËSHTIRËSI NË POKROVSK (DHE NË FRONTE TË TJERA)



Larg duart nga Druzhba. Kryeministri hungarez Viktor Orbán dhe kryeministri sllovak Robert Fico i kishin paralajmëruar ukrainasit: mjerë ata që prekin tubacionin që transporton naftën e Putinit në vendet më putiniste evropiane. Dhe vetëm të premtën e kaluar, kur u prit në Kremlin, Orbán përsëriti se Budapesti do të injoronte politikat e BE-së dhe do të vazhdonte të blinte energji nga Moska. Natën e së martës, ndodhi një shpërthim . I shkaktuar nga një detonator i largët, në territorin rus dhe bjellorus dhe vetëm 40 km nga kufiri ukrainas. Druzhba - një nga tubacionet më të mëdha të naftës në botë, një qendër 9,000 kilometra e afhtë të përpunojë dy milionë fuçi në

ditë, një rrjet thelbësor për furnizimin e trupave të Operacionit Special Ushtarak - ka shpërthyer. Është sulmi i pestë në vetëm pak muaj dhe më seriozi. Hungarezët dhe sllovakët po e minimizojnë situatën, duke thënë "nuk ka dëme të vërteta në furnizimet tona", por mesazhi është i qartë: oficerët e inteligjencës ukrainase nga GUR kanë marrë urdhra për të goditur fort energjinë. Kjo shpjegon gjithashtu fundosjen e dy tankerëve rusë në Detin e Zi në ditët e fundit, duke shmangur sanksionet. E njëjta gjë vlen edhe për zjarrin misterioz në një anije që ngarkonte naftë në brigjet e Senegalit. "Rrjeti rus i naftës që financon shtetin agresor dhe kompleksin e tij ushtarako-

industrial", shpjegon një burim i inteligjencës në Kiev, "do të vazhdojë të digjet derisa të ndalet agresioni". Lufta e gazit hyn në dimrin e saj të katërt dhe është ndoshta risia e vërtetë e kundërsulmit ukrainas, i cili po përjeton vështirësi të mëdha në frontin e Pokrovskut dhe pika të ndryshme në Donetsk, si dhe në llogoret prej 1,300 km. Buxheti i shtetit është miratuar dhe këtë vit 100% e të gjitha të ardhurave do të ndahen për mbrojtje: 57 miliardë euro (60%) për ushtrinë, vetëm 20 milionë për çerdhet për personat e zhvendosur. Edhe gjeneralët në terren po përqendrohen në çështjet më të diskutueshme, ato të planit Trump të diskutuara për pesë orë në Moskë .

Sulmet ruse në orët e fundit kanë synuar rajonin e Zaporizhzhya-s, një nga pesë rajonet që Putini do të donte të aneksonte për të përthithur të paktën gjysmën e prodhimit bërthamor të Kievit. Ukrainasit, përveç energjisë, po mbledhin dosjet më të ndjeshme mbi krimet e luftës, të cilat draft-plani kërkon fshirjen me anë të një amnistie. "Nuk e dimë nëse Putini do të dalë ndonjëherë në gjyq", thotë një burim në Zyrën e Prokurorit Special të Kievit, "por njerëzit e tij me siguri do të dalin". Njëri mbi të gjitha, "Doktori i Keq", siç e quajnë të burgosurit ukrainas të tmerrshmin Ilya Sorokin : një infermier rus që shërbente në koloninë penale 10 në rajonin e Mordovisë, i cili torturonte sistematikisht


ushtarët armik në klinikën e burgut. Shërbimet e SBU-së kanë përgatitur një padi të konsiderueshme për t'u dërguar në Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë. Dhe rrëfimet e të burgosurve janë të tmerrshme: Doktori i Keq nuk u dha qetësues kundër dhimbjeve të përshkruara nga mjekët, u mohoi fashat më të plagosurve rëndë dhe këmbënguli që të vdisnin nga gjakderdhja. Akti i tij i vetëm i mëshirës, si të thuash, ishte përdorimi i një arme elektrike për t'i lënë të burgosurit pa ndjenja dhe për të paralizuar pjesë të caktuara të trupit: "Ai tha se e bëri sepse, në këtë mënyrë, ne të burgosurit ndjenim më pak dhimbje." (Corriere della Sera)

KËRCËNON MEDVEDEV: SEKUESTRIMI I ASETEVE NGA BE-ja MUND TË BËHET SHKAK PËR LUFTË

Rusia paralajmëroi të enjten se nëse Bashkimi Evropian vendos të sekuestrojë asetet e saj të ngrira, mund ta shohë këtë si një "casus belli", një term latin që do të thotë "rast për luftë". Në një deklaratë në platformën mediatike ruse MAX, Zëvendës Sekretari i Këshillit të Sigurisë Ruse Dmitry Medvedev tha: "Nëse Bashkimi Evropian i çregulluar vazhdon të përpiqet të vjedhë asetet ruse të bllokuara në Belgjikë duke lëshuar një të ashtuquajtur kredi dëmshpërblimi, veprime të

tilla sipas ligjit ndërkombëtar mund të kualifikohen si një lloj i veçantë i casus belli, me të gjitha pasojat që vijnë për Brukselin dhe vendet individuale të BE-së. Dhe pastaj kthimi i këtyre fondeve mund të ndodhë jo përmes një gjykate, por përmes dëmshpërblimeve aktuale, të paguara në natyrë nga armiqtë e mundur të Rusisë." Medvedev shërbeu si president i Rusisë nga viti 2008 deri në vitin 2012 dhe është i njohur për deklaratat e tij provokuese.





FFK-ja: Kosova renditet e 41-a në listën e “Fair-Play” të UEFA-s

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Kombëtarja e Kosovës në futboll është renditur e 41-ta në listën e UEFA-s për sa i përket “fair-play”-it.

Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), ka vlerësuar se ky është një tjetër tregues i përkushtimit, disiplinës dhe frymës sportive në

fushë. “FFK-ja me ekipet kombëtare dhe klubet e saj janë të përkushtuara për respekt, lojë të pastër dhe sportivitet të cilat

po japin rezultat. Krenarë për progresin dhe vlerat që po ndërtojmë”, është thënë në njoftimin e FFK-së.



VOJVODA: KUALIFIKIMI NË BOTËROR DO TË ISHTE REALIZIM I ËNDRRËS SË FËMIJËRISË

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Mërgim Vojvoda, një prej shtyllave të mbrojtjes së Kombëtares së Kosovës, në episodën më të ri në “FFK Podcast” ka shpalosur emocionet, synimet dhe realizmin e një futbollisti që ka kaluar vite të rëndësishme me fanellën e Dardanëve. Për të, kualifikimi në Kampionatin Botëror 2026 do të ishte kulmi i karrierës dhe realizimi i ëndrrës së fëmijërisë. Ai ka theksuar se një sukses i tillë do të kishte peshën e një momenti që e tejkalon çdo arritje individuale.

Në analizën e tij për duelin e parë të “play-off”-it, Vojvoda e sheh sfidën kundër Sllovakisë si tërësisht të hapur, duke vlerësuar se ekipi i Kosovës ka treguar pjekuri dhe karakter

për ta çuar deri në fund këtë rrugëtim. Sipas tij, fakti që finalja e mundshme luhet në shtëpi i jep “Dardanëve” një ndjenjë shtesë besimi dhe motivimi.

Një prej pikave të rëndësishme që ai ka theksuar është gjendja fizike e lojtarëve, të cilën e sheh si faktor kyç në ndeshje të këtij niveli. Përballjet e “play-off”-it i ka cilësuar si finale të vërteta, ku çdo detaj, qoftë energjia, freskia apo përqendrimi, mund të bëjë diferencën.

Vojvoda është ndalur edhe te ndryshimet mes gjeneratave, duke vlerësuar se lojtarët e rinj të Kombëtares po tregojnë disiplinë, përqendrim dhe respekt të jashtëzakonshëm për fanellën. Ai ka veçuar me admirim sakrificat e disa prej



tyre që udhëtojnë me orë të tëra nga vende të largëta vetëm për të qenë pjesë e Kosovës, duke e cilësuar këtë përkushtim si shembull frymëzues. Në rikthimin e tij emocionues te humbja e ashpër kundër Zvicrës në nisje të kualifikimeve, Vojvoda ka

pranuar se ekipi e përjetoi rëndë atë rezultat. Megjithatë, ai shtoi se pikërisht ajo sfidë shërbeu si pikë kthese, sepse nga ajo ndeshje grupi ndryshoi qasjen, u bë më kompakt dhe më i bashkuar. Ky transformim, sipas tij, ishte themelor në arritjen e “play-off”-it. Ai ka

folur edhe për rritjen e mentalitetit brenda ekipit, krahasuar me vitet e para të Kombëtares, duke theksuar se sot çdo lojtar është i vetëdijshëm për rëndësinë e ekipit mbi individin. Sipas tij, Kosova po i afrohet mënyrës së të menduarit që kanë kombëtares të mëdha, ku gjithsecili, qoftë titullar apo lojtar që futet nga bankina, e di detyrën dhe jep maksimumin për tri pikët. Në fund, Vojvoda është ndalur edhe te Como, skuadra e tij në Serinë A, duke folur për sfidat e kampionatit italian dhe pritjet personale për edicionin aktual, ku ai synon të kontribuojë maksimalisht si në klub ashtu edhe në Kombëtare. Ai ka folur edhe për ndodhi të ndryshme gjatë karrierës së tij.

BYLBYL SOKOLI LARGOHET NGA DRENICA

SKENDERAJ, 4 DHJETOR - Klubi i Futbollit Drenica ka bërë me dije se ka marrë fund bashkëpunimi i tyre me trajnerin Bylbyl Sokoli. Nga klubi kanë thënë se ndarja ka ndodhur me mirëkuptim të plotë dhe në një frymë korrekte dhe respekt profesional. Klubi e falënderon sinqerisht profesor Sokolin për të gjithë kontributin e dhënë, nga rikthimi në Superligë deri te puna e tij këtë sezon në komponimin dhe përgatitjen e skuadrës. Kontributi i tij mbetet i vlerësuar nga drejtuesit, futbollistët dhe çdo njeri që e do FC Drenicën.



Profesor Sokoli do të mbetet gjithmonë pjesë e historisë sonë dhe do të ketë respektin më të lartë nga klubi dhe komuniteti. FC Drenica vazhdon përpara me qartësi, profesionalizëm dhe objektiva të mëdha. Klubi ynë është i përkushtuar të ndërtojë një

projekt serioz, afatgjatë dhe me ambicie të qarta për të çuar Drenicën në arenën evropiane”, ka njoftuar Drenica. Mbetet të shihet gjatë ditëve në vazhdim se kush do të jetë i përzgjedhuri nga kryesia e Drenicës për ta pasuar Sokolin në stol.

FAVORITËT AVANCOJNË TUTJE NË KUPËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Dinamo, Vushtrria, Vëllaznimi dhe Feronikeli '74 kanë konfirmuar statusin e skuadrave favorite pasi kanë avancuar në raundin tjetër të Kupës së Kosovës në futboll. Të katër skuadrat që bëjnë garojnë në Ligën e Parë të Kosovës, të enjten kanë shënuar fitore në udhëtim në kuadër të 1/16 të finales të Kupës së Kosovës. Dinamo e Ferizajt triumfoi në udhëtim te 2 Korrik me shifrat 3:0 për të avancuar në 1/8 e finales të kësaj gare. Ndërkohë, me rezultatin 2:0, fituan Vëllaznimi i Gjakovës, Vushtrria dhe Feronikeli '74. Vëllaznimi

KUPA E KOSOVËS 1/16		
	VS	0 - 3
	VS	0 - 2
	VS	0 - 2
	VS	2 - 1
	VS	0 - 2
	VS	0 - 2

mposhti në udhëtim skuadrën e KEK-ut, Vushtrria në kryeqytet ka eliminuar Flamurtarin e Prishtinës kurse Feronikeli '74 ka fituar ndaj ekipit Istog 03.

Barcelona po heziton të paguajë 30 milionë euro për Rashfordin

BARCELONË, 4 DHJETOR - Vazhdimësia e Marcus Rashfordit te Barcelona është kthyer në një nga çështjet më delikate me të cilat po përballlet drejtimi sportiv në mes të sezonit. Edhe pse sulmuesi anglez ka reaguar me statistika

më shumë se të pranueshme, qëndrimi i tij ende nuk është i garantuar, dhe informacionet e fundit e kanë rindezur debatin në qytetin e Barcelonës. Shifrat flasin vetë: gjashtë gola dhe tetë asistime në 18 ndeshje. Megjithatë, as kjo paraqitje nuk

ka arritur të heqë dyshimet rreth mundësisë së aktivizimit të opsionit të blerjes, i cili kap shifrën e rreth 30 milionë eurove, një vendim që mbetet ende pezull. Siç raporton “Sport”, pengesa kryesore qëndron te përshtatja e tij brenda sistemit të

Hansi Flick, ku presioni i lartë dhe puna pa top janë elemente të panegociueshme. Ky stil e ka lënë Marcus Rashfordin në një pozitë të pakëndshme, pasi profili i tij nuk përputhet plotësisht me ritmin agresiv që kërkon trajneri gjerman.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Galeria Studio” Sh. P. K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811882390 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Galeria Studio" D. O. O. od Ljipljan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811882390 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Galeria Studio” L. L. C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 811882390 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Selman Dodaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Donjeta Vehapi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “28 Nëntori”.
- D.P.T. “Pelikan” Blerimm Lladrovci B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811546970.
- Hysni Hameli shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” në Mazdrek të Hasit.
- Egzon Makolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Drenas.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

